



GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS



Buletini Informativ

Korrik — Dhjetor 2022

Kushtetuta e Kosovës - Kapitulli VIII

Gjykata Kushtetuese

Neni 112

[Parimet e Përgjithshme]

PËRMBAJTJA:

RAPORTI GJASHTËMUJOR I PUNËS2

VIZITAT DHE AKTIVITETET E GJYKATËS.....4

AKTGJYKIME9

GJEDNJ - VENDIME TË RËNDËSISHME13

Gjykata Kushtetuese është autoriteti përfundimtar në Republikën e Kosovës për interpretimin e Kushtetutës dhe të përputhshmërisë së ligjeve me Kushtetutën.

Gjykata Kushtetuese është plotësisht e pavarur në kryerjen e përgjegjësisë së saj.

Përbërja e Gjykatës Kushtetuese

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës përbëhet nga 9 (nëntë) gjyqtarë.

Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës emërohen në pajtim me nenin 114 [*Përbërja dhe Mandati i Gjykatës Kushtetuese*] të Kushtetutës, dhe të neneve 6 dhe 7 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

Pas themelimit të Gjykatës Kushtetuese në vitin 2009 dhe në pajtim me nenin e mëparshëm 152 [*Përbërja e Përkohshme e Gjykatës Kushtetuese*] të Kushtetutës, 6 (gjashtë) nga 9 (nëntë) gjyqtarët u emëruan nga Presidenti i Republikës së Kosovës me propozimin e Kuvendit.

Nga 6 (gjashtë) gjyqtarët vendorë, 2 (dy) gjyqtarë shërbyen për një mandat 3 (tre) vjeçar, pa mundësi të rizgjedhjes, 2 (dy) gjyqtarë shërbyen për një mandat prej 6 (gjashtë) vjetësh, pa mundësi të rizgjedhjes, dhe 2 (dy) gjyqtarë shërbyen për një mandat prej 9 (nëntë) vjetësh, pa mundësi të rizgjedhjes.

Në pajtim me nenin e lartpërmendur 152 [*Përbërja e Përkohshme e Gjykatës Kushtetuese*] të Kushtetutës, 3 (tre) gjyqtarë ndërkombëtarë u emëruan nga Përfaqësuesi Ndërkombëtar Civil, pas konsultimit me Kryetarin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

* Gjykata aktualisht përbëhet nga 8 (tetë) gjyqtarë.






Statusi i lëndëve

Gjatë periudhës gjashtëmuajore: 1 korrik – 31 dhjetor 2022, Gjykata ka pranuar 121 kërkesa të reja, ndërsa ka pasur në punë gjithsej 271 kërkesa/lëndë.

Gjithsej 90 kërkesa janë zgjidhur ose 33.21% e të gjitha rasteve në dispozicion.

Gjatë kësaj periudhe, 82 vendime janë publikuar në ueb-faqen e Gjykatës.

*Dinamika e kërkesave të pranuar sipas muajve
(1 korrik – 31 dhjetor 2022)*



Në vijim janë paraqitur 8 aktgjykimet që Gjykata i nxori gjatë periudhës gjashtëmuajore, 1 korrik – 31 dhjetor 2022:

- Aktgjykim në rastin KI 10/22, parashtruar nga: Sindikata e Institutit të Mjekësisë Ligjore. Në kërkesën e parashtruar u kërkuar vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës [PmlARJ.nr. 115/2021], të datës 18 nëntor 2021.
- Aktgjykim në rastin KI 19/21, parashtruar nga: Sadik Pllana. Në kërkesën e parashtruar u kërkuar vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës [Rev.nr. 239/2019], të datës 26 nëntor 2020.
- Aktgjykim në rastin KI 116/21, parashtruar nga: “Sali Rexhepi. Në kërkesën e parashtruar u kërkuar vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës [Rev. nr. 104/20], të datës 25 shkurt 2021.
- Aktgjykim në rastin KI 230/21, parashtruar nga: “Global Trade-af” sh.p.k. Në kërkesën e parashtruar u kërkuar vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës [ARJ-UZVP-nr. 45/2021], të datës 28 prill 2021.

- Aktgjykim në rastin KI 202/21, parashtruar nga: “Kelkos Energy” sh.p.k. Në kërkesën e parashtruar u kërkuar vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme Republikës së Kosovës [ARJ.UZVP.Nr.74/21], të datës 28 korrik 2021.
- Aktgjykim në rastin KI 159/20, parashtruar nga: “ADOL” sh.p.k. Në kërkesën e parashtruar u kërkuar vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës [AcRev.nr. 29/19,], të datës 1 korrik 2020.
- Aktgjykim në rastin KI 44/21, parashtruar nga: Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës. Në kërkesën e parashtruar u kërkuar vlerësimi i kushtetutshmërisë së nenit 94 (Mbikëqyrja) të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës.
- Aktgjykim në rastin KO 173/21, parashtruar nga: Komuna e Kamenicës. Në kërkesën e parashtruar u kërkuar vlerësimi i kushtetutshmërisë së neneve 3, 4, 5, 6, 7 dhe 9 të Udhëzimit Administrativ të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës (MASH) nr. 104/2020 për “Kriteret dhe Procedurat e Themelimit dhe Pushimit të Veprimtarisë së Institucioneve të Arsimit Parauniversitar”.

Llojet e shkeljeve të pretenduara

Llojet e shkeljeve të pretenduara nga 121 kërkesat e pranuar gjatë periudhës gjashtëmuajore, 1 korrik – 31 dhjetor 2022, janë si në vijim:


- Neni 3 [Barazia para Ligjit], 9 raste ose 3%;
- Neni 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit], 2 raste ose 0,7%;
- Neni 7 [Vlerat], 5 raste ose 1,7%;
- Neni 13 [Kryeqyteti], 2 raste ose 0,7%;
- Neni 19 [Zbatimi i së Drejtës Ndërkombëtare], 2 raste ose 0,7%;
- Neni 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], 8 raste ose 2,7%;
- Neni 23 [Dinjiteti i Njeriut], 2 raste ose 0,7%;
- Neni 24 [Barazia para Ligjit], 30 raste ose 10%;
- Neni 25 [E Drejta për Jetën], 2 raste ose 0,7%;
- Neni 29 [E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë], 4 raste ose 1,3%;
- Neni 30 [Të Drejtat e të Akuzuarit], 4 raste ose 1,3%;
- Neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 89 raste ose 29,7%;
- Neni 32 [E Drejta për Mjete Juridike], 22 raste ose 7,3%;

- Neni 33 [Parimi i Legalitetit dhe Proporcionalitetit në Rastet Penale], 2 raste ose 0,7%;
- Neni 36 [E Drejta e Privatësisë], 2 raste ose 0,7%;
- Neni 45 [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes], 2 raste ose 0,7%;
- Neni 46 [Mbrojtja e Pronës], 19 raste ose 6,3%;
- Neni 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit], 11 raste ose 3,7%;
- Neni 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut], 11 raste ose 3,7%;
- Neni 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave], 30 raste ose 10%;
- Neni 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore], 4 raste ose 1,3%;
- Neni 101 [Shërbimi Civil], 2 raste ose 0,7%;
- Neni 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor], 11 raste ose 3,7%;
- Neni 109 [Prokurori i Shtetit], 4 raste ose 1,3%;
- Neni 110 [Këshilli Prokurorial i Kosovës], 2 raste ose 0,7%;
- Shkelje të tjera, 19 raste ose 6,3%;

Autorët e supozuar të shkeljes së të drejtave

- 111 kërkesa ose 91.7% e kërkesave kanë të bëjnë me vendimet e gjykatave;
- 10 kërkesa ose 8.3% e kërkesave kanë të bëjnë me vendimet e autoriteteve të tjera publike;

*Shkelësit e supozuar të të drejtave
(1 korrik – 31 dhjetor 2022)*



Seancat dhe kolegjet shqyrtuese


Gjatë periudhës gjashtëmujore: 1 korrik – 31 dhjetor 2022, Gjykata Kushtetuese ka mbajtur 23 seanca plenare dhe 112 kolegje shqyrtuese, në të cilat rastet e shqyrtuara u zgjidhën me aktgjykime, aktvendime dhe vendime.

Gjatë kësaj periudhe, Gjykata Kushtetuese ka publikuar gjithsej 82 vendime.

Struktura e vendimeve të publikuara është si në vijim:

- 8 Aktgjykime (9,8%);
- 68 Aktvendime për papranueshmëri (82,9%);
- 3 Vendime për refuzim të kërkesës me procedurë të shkurtër (3,7%);
- 1 Vendim për tërheqje të kërkesës (1,2 %);
- 2 Urdhëra tjerë (2,4 %);

*Struktura e vendimeve të publikuara
(1 korrik – 31 dhjetor 2022)*




Qasja në Gjykatë

Qasja e individëve në Gjykatë është si në vijim:

- 96 kërkesa nga shqiptarët, ose 95%;
- 4 kërkesa nga komuniteti serb, ose 4%;
- 1 kërkesë nga komuniteti boshnjak, ose 1%;

*Struktura etnike e parashtruesve të kërkesave
(1 korrik – 31 dhjetor 2022)*



15 korrik 2022



Një grup studentësh të Fakultetit Juridik të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, të shoqëruar nga përfaqësuesit e organizatës joqeveritare “Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut – Kosovë (YIHR KS)”, qëndruan për vizitë në Gjykatën Kushtetuese. Ata u pritën në takim nga gjyqtarja e Gjykatës Kushtetuese, znj. Remzie Istrefi – Peci dhe Juriskonsulti i Gjykatës, z. Sevdail Kastrati.

Gjatë takimit me studentë, gjyqtarja Istrefi – Peci bëri një prezantim të shkurtër përkitazi me përbërjen dhe strukturën organizative të Gjykatës, rolin dhe funksionin e saj, palët e autorizuara për parashtrimin e kërkesave, procesin e përgatitjes së raporteve paraprake nga këshilltarët dhe gjyqtarët e rastit, si dhe rëndësinë e mbrojtjes së të drejtave të njeriut në vend.

Nga ana e tyre, studentët shprehën interesimin që të informohen më hollësisht përkitazi me numrin e lëndëve që ende janë në procedurë të shqyrtimit nga Gjykata, rastet dhe vendimet më me ndikim në opinion, numrin e aktvendimeve për papranueshmëri, si dhe për mundësitë që i kanë qytetarët e Republikës së Kosovës për t’iu qasur Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në Strasburg.

22 korrik 2022



Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, në krye me kryetaren e Gjykatës, znj. Gresa Caka – Nimani, qëndruan për vizitë pune në Tiranë, me ftesë të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë. Delegacioni i gjyqtarëve nga Kosova u ftua për të marrë pjesë në punëtorinë e organizuar nga Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë, në bashkëpunim me Institutin për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) në Tiranë dhe me mbështetje të Agjencisë Suedeze për

Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar (SIDA), që për qëllim kishte hartimin e Kodit të Etikës të kësaj gjykate. Punëtorja i filloi punimet me fjalët hyrëse të kryetareve të gjykatave kushtetuese të Shqipërisë dhe Kosovës, znj. Vitore Tusha dhe znj. Gresa Caka – Nimani, ndërsa gjyqtari Nexhmi Rexhepi prezantoi këndvështrimin e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës përkitazi me kodin e etikës së gjyqtarëve.

2 shtator 2022



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, znj. Gresa Caka – Nimani dhe gjyqtarja e Gjykatës Kushtetuese, znj. Remzie Istrefi – Peci, qëndruan për vizitë pune në Galway të Irlandës, me ftesë për të marrë pjesë në Konferencën ndërkombëtare me temë: “Zbatimi efektiv i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në zonat evropiane në konflikt”. Në konferencën e organizuar nga Ministria e Punëve të Jashtme të Irlandës, në bashkëpunim me Qendrën Irlandeze për të Drejtat e

Njeriut, njëra nga panelistët pjesëmarrës ishte edhe kryetarja Caka – Nimani, e cila mbajti një prezantim në temën: “Zbatimi efektiv i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut: Perspektiva e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës”. Gjatë qëndrimit në Galway, kryetarja Caka – Nimani dhe gjyqtarja Istrefi – Peci zhvilluan takime të ndara me akademikë dhe juristë të shquar ndërkombëtarë në fushën e të drejtave të njeriut, si dhe me gjyqtarë të gjykatave kushtetuese evropiane.

16 shtator 2022

Gjyqtaret e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, znj. Selvete Gërxhaliu – Krasniqi dhe znj. Remzie Istrefi – Peci, qëndruan për vizitë pune dyditore në Riga të Letonisë.

Ato u ftuan nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Letonisë për të marrë pjesë në konferencën ndërkombëtare me temë: “Qëndrueshmëria si një vlerë kushtetuese: Sfidat e së ardhmes”, organizuar në shënim të 30-vjetorit të themelimit të kësaj gjykate dhe 100-vjetorit të miratimit të Kushtetutës së Letonisë.



Gjatë qëndrimit në Riga, gjyqtaret Gërxhaliu – Krasniqi dhe Istrefi – Peci zhvilluan takim të përbashkët me kryetarin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Letonisë, z. Aldis Laviņš, si dhe me homologë të tjerë nga gjykatat kushtetuese evropiane pjesëmarrës në konferencë.

20 shtator 2022



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, znj. Gresa Caka – Nimani dhe gjyqtarja e Gjykatës Kushtetuese, znj. Remzije Istrefi – Peci, pritën në takim të përbashkët një grup studentësh ndërkombëtar të Programit Evropian (EMA) për studime pasuniversitare në fushën e të drejtave të njeriut dhe demokratizim, nga kampuset universitare në Vjenë dhe Venedik.

Gjatë prezantimit të tyre, kryetarja Caka – Nimani dhe gjyqtarja Istrefi – Peci fillimisht i informuan studentët me historikun e Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe obligimin kushtetues për respektimin e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, me rolin dhe funksionin e Gjykatës Kushtetuese në sistemin shtetëror të Republikës së Kosovës, si dhe me sfidat me të cilat është ballafaquar deri më tani kjo gjykatë në punën e saj. Në vijim të takimit, studentët shprehën interesimin e tyre që të informohen më hollësisht përkitazi me respektimin e Paktit Ndërkombëtar mbi të Drejtat Ekonomike, Kulturore dhe Sociale në nivel vendi, me procesin e parashtrimit të kërkesave

individuale në Gjykatë, për numrin e parashtrimit të kërkesave nga pjesëtarët e komuniteteve joshumicë dhe publikimin e vendimeve në gjuhët e tyre, si dhe për respektimin dhe zbatimin e vendimeve të Gjykatës.

29 shtator 2022



Në kuadër të programit trajnues të organizuar nga OJQ “Grupi për Ballkan”, me temë: “*Të rinjtë në Politikë: Qeverisja dhe Sistemet Politike*”, aktivistë të forumeve rinore të partive politike të Kosovës vizituan Gjykatën Kushtetuese.

Ata u pritën në takim nga gjyqtarët, znj. Selvete Gërxhaliu – Krasniqi dhe z. Nexhmi Rexhepi, të cilët gjatë prezantimit të tyre diskutuan mbi rolin dhe rëndësinë e Gjykatës Kushtetuese në sistemin juridik të Republikës së Kosovës, për përbërjen e parë dhe aktuale të gjyqtarëve kushtetues, për raportin me gjykatat e rregullta dhe organet e tjera shtetërore në vend, si dhe për palët e autorizuar për parashtrimin e ankesave kushtetuese.

Gjatë takimit, politikanët e rinj shprehën interesimin e tyre që të informohen më në detaje përkitazi me llojet e vendimeve që nxjerrë Gjykata, për procesin e votimit dhe kuorumin e nevojshëm për vendimmarrjen e gjyqtarëve, për natyrën e kërkesave kushtetuese dhe numrin e tyre, si dhe për mundësitë e ankimimit ndaj vendimeve të Gjykatës Kushtetuese.

7 tetor 2022

Një delegacion i gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, i udhëhequr nga kryetarja e Gjykatës, znj. Gresa Caka – Nimani, qëndroi për vizitë zyrtare në Bali të Indonezisë, me ftesën për të marrë pjesë në Kongresin e 5-të të Konferencës Botërore të Drejtësisë Kushtetuese (WCCJ).

Delegacioni i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës udhëtoi për në Bali me ftesë të Komisionit të Venecias dhe të Gjykatës Kushtetuese të Indonezisë, si mikpritëse dhe bashkë-organizatore e Kongresit të 5-të të Konferencës Botërore të Drejtësisë Kushtetuese (WCCJ), që këtë vit u organizua në temën: “*Drejtësia kushtetuese dhe paqja*”. Burimet e së drejtës, përgjegjësitë dhe kufizimet e rolit të gjykatave kushtetuese në ruajtjen e paqes, parimet themelore ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe shqyrtimi i pavarësisë së gjykatave kushtetuese, ishin vetëm disa



prej temave mbi të cilat shkëmbyen pikëpamjet e tyre profesionale kryetarët dhe gjyqtarët e gjykatave kushtetuese dhe supreme nga 90 shtete anëmbanë botës.

Gjatë qëndrimit në Bali, kryetarja Caka – Nimani u takua me kryetarin “emeritus” të Komisionit të Venecias, z. Gianni Buquicchio, me Sekretarin e përgjithshëm të Konferencës Botërore të Drejtësisë Kushtetuese (WCCJ), z. Rudolph Dürr Schnutz, me kryetarë të disa gjykatave kushtetuese dhe supreme anëtare të WCCJ-së, si dhe me përfaqësues të Asociacionit Frankofon të Gjykatave Kushtetuese dhe të Konferencës Evropiane të Gjykatave Kushtetuese.

Gjykata Kushtetuese e Kosovës është bërë anëtare me të drejta të plota e Konferencës Botërore të Drejtësisë Kushtetuese (WCCJ), më 17 shtator 2014.

11 tetor 2022



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, znj. Gresa Caka – Nimani, priti në takim ministrin e Drejtësisë të Republikës së Shqipërisë, z. Ulsi Manja. Përbërja aktuale dhe puna e deritanishme e Gjykatës Kushtetuese, natyra e kërkesave të parashtruara dhe përpjekjet për konsolidimin e praktikës gjyqësore në harmoni me praktikën e Gjykatës Evropiane

për të Drejtat e Njeriut, ishin vetëm disa prej temave rreth të cilave kryetarja Caka – Nimani e informoi ministrin Manja.

Në vijim të diskutimit, kryetarja Caka – Nimani vuri theksin në marrëdhëniet e shkëlqyera të bashkëpunimit me Gjykatën Kushtetuese të Shqipërisë, si dhe kontributin e çmuar që kjo gjykatë vazhdon të ofrojë në përpjekjet e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës për anëtarësim në forumet ndërkombëtare profesionale të gjykatave kushtetuese. Të dyja palët nënvizuan rëndësinë dhe domosdoshmërinë e ruajtjes së pavarësisë të sistemit gjyqësor dhe të avancimit të kornizës ligjore të të dyja vendeve duke përvetësuar standardet evropiane, si parakushte esenciale për forcimin e demokracisë, konsolidimin e shtetit të së drejtës dhe mbrojtjen efektive të të drejtave dhe lirive të individit.

Në takimin e përbashkët të kryetares Caka – Nimani dhe ministrit Manja morën pjesë edhe ministrja e Drejtësisë e Republikës së Kosovës, znj. Albulena Haxhiu dhe ambasadori i Republikës së Shqipërisë në Kosovë, z. Qemajl Minxhozi.

21 tetor 2022



Një delegacion i gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, i udhëhequr nga kryetarja e Gjykatës, znj. Gresa Caka – Nimani, qëndroi për vizitë zyrtare në Tiranë, me ftesë të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.

Delegacioni i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës u ftua për të marrë pjesë në ceremoninë e shënimit të 30-vjetorit të themelimit të Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë dhe në Konferencën ndërkombëtare të organizuar me këtë rast, në temën: “Roli i Gjykatave Kushtetuese në demokracitë e reja”.

Kryetarja Caka – Nimani, në cilësinë e njëjës nga folëset kryesore në Konferencën ndërkombëtare, me pjesëmarrës kryetarë dhe gjyqtarë të gjykatave kushtetuese dhe supreme rajonale dhe evropiane,

mbajti një prezantim në temën e jurisprudencës kushtetuese, si garanci për konsolidimin e shtetit të së drejtës.

Gjatë qëndrimit në Tiranë, kryetarja Caka – Nimani dhe gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës u pritën në takim të përbashkët nga kryetarja e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, znj. Vitore Tusha dhe gjyqtarët e tjerë të kësaj gjykate.

11 nëntor 2022



Një grup studentësh të viteve të fundit të fakulteteve juridike nga universitetet anembanë vendit, të shoqëruar nga përfaqësues të Institutit të Kosovës për Drejtësi (IKD), qëndruan për vizitë në Gjykatën Kushtetuese. Studentët u pritën në takim nga kryetarja e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, znj. Gresa Caka – Nimani dhe Juriskonsulti i Gjykatës, z. Sevdail Kastrati. Rolin dhe funksioni që ka Gjykata Kushtetuese në sistemin shtetëror të Republikës së Kosovës, përbërja e saj në vitet e para të funksionimit me gjyqtarë dhe staf ndërkombëtar, burimet e së drejtës kushtetuese dhe shterja e mjeteve juridike para dorëzimit të kërkesave në Gjykatë, ishin vetëm disa ndër temat për të cilat kryetarja Caka – Nimani diskutoi para studentëve.

Juristët e ardhshëm ndërkaq shprehën interesimin e tyre që të informohen më hollësisht përkitazi me zbatimin e praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në vendimmarrjen e Gjykatës, për procesin e përzgjedhjes dhe mandatin e gjyqtarëve kushtetues, si dhe për të drejtën e apelimit të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese.

30 nëntor 2022

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, znj. Gresa Caka – Nimani, qëndroi për vizitë zyrtare disaditëshe në Paris, më 30 nëntor – 2 dhjetor 2022, që u realizua me mbështetjen e ambasadës së Francës në Republikën e Kosovës.

Në ditën e parë të vizitës, kryetarja Caka-Nimani u takua me kryetarin e Këshillit Kushtetues të Francës, z. Laurent Fabius, dhe me kryetarin e Këshillit Shtetëror të Francës, z. Didier – Roland Tabuteau. Temë e diskutimeve të përbashkëta, në të dy takimet,

ishin të arriturat e Kosovës në fushën e sundimit të ligjit, respektimin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore në nivel vendi. Në takimet e ndara me z. Fabius dhe z. Tabuteau, kryetarja vuri theksin edhe në nevojën e thellimit të bashkëpunimit ndër-institucional ndërmjet institucioneve përkatëse



me qëllim të shkëmbimit të përvojave dhe të njohurive praktike në fushat me interes reciprok. Në ditën e dytë të vizitës në Paris, kryetarja Caka – Nimani zhvilloi një sërë takimesh me zyrtarë të lartë të Senatit francez, të ngarkuar me çështjet politike, legislative dhe të drejtat e njeriut për rajonin e Kosovës dhe Ballkanin Perëndimor, përfshirë Nënkryetaren e Senatit Valerie Letard dhe Senatoren Laure Darcos, që gjithashtu udhëheq grupin ndërparlamentar të miqësisë ndërmjet Francës dhe Ballkanit Perëndimor. Kryetarja Caka – Nimani vizitën në kryeqytetin francez e përmbylli me takimin e përbashkët me kryetarin e Gjykatës së Kasacionit të Francës, z. Christophe Soulard, me të cilin ndërmjet tjerash diskutuan përkitazi me sfidat në procedurat e kontrollit kushtetues dhe interpretimin uniform të ligjeve në të dyja vendet dhe për mundësitë e bashkëpunimit në të ardhmen ndërmjet dy Gjykatave.

9 dhjetor 2022

Në aktivitetin e radhës “Dita e Gjykatës së Hapur”, organizuar në shënim të Ditës Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut, Gjykatën Kushtetuese e vizituan studentët e Fakultetit Juridik të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, një grup qytetarësh dhe përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile në Kosovë.

Studentët u pritën në takim nga kryetarja e Gjykatës Kushtetuese, znj. Gresa Caka – Nimani, e cila gjatë prezantimit të saj bëri një përshkrim të shkurtër të historikut të themelimit të Gjykatës, të përbërjes së parë me gjyqtarë dhe zyrtarë ndërkombëtarë, krahas atyre vendor, si dhe për sfidat e përballura gjatë trajtimit të çështjeve të ndryshme kushtetuese, mbi të cilat edhe janë vënë themelet e gjyqësisë kushtetuese të Republikës së Kosovës.



Në vijim të prezantimit të saj, kryetarja Caka – Nimani foli edhe për rëndësinë që ka në nivel global Dita Ndërkombëtare e të Drejtave të Njeriut, si dhe për respektimin e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe zbatimin e praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në çdo vendim të Gjykatës Kushtetuese.

Studentët nga ana e tyre shprehën interesimin që të informohen më për së afërmi përkritazi me raportin e Gjykatës Kushtetuese me gjyqësorin e rregullt, me kriteret e parashtrimit të kërkesave në Gjykatë, me procedurën e shqyrtimit të tyre dhe vendimmarrjen, si dhe për të drejtën e kompensimit të palëve në procedurë dhe të drejtën e ankimit në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut me seli në Strasburg.



Në “Ditën e Gjykatës së Hapur”, kryetarja Caka – Nimani, e shoqëruar nga gjyqtarja Selvete Gërxhaliu – Krasniqi, pritën në vizitë edhe një grup juristësh dhe praktikantësh të angazhuar në kuadër të projektit “Just React” të organizatës joqeveritare “Grupi për Studime Juridike dhe Politike”, për monitorimin e punës së gjykatave të rregullta në Republikën e Kosovës. Afatet për parashtrimin e ankesave kushtetuese, numri i lëndëve të pashqyrtuara dhe obligimi kushtetues për zbatimin e vendimeve të Gjykatës, ishin vetëm disa ndër çështjet për të cilat juristët e rinj shprehën interesimin që të informohen më hollësisht.

17 dhjetor 2022

Ekspertja amerikane me përvojë të gjatë në fushën e komunikimit të brendshëm dhe zhvillimit organizativ, dhe njëherësh ligjëruese në Universitetin e Kolumbias të SHBA, Prof. Dr. Aileen Webb, qëndroi për vizitë në Gjykatën Kushtetuese, më 5 – 16 dhjetor 2022.

Përgjatë qëndrimit gati dyjavor në Gjykatë, znj. Webb zhvilloi dhe zbatoi në praktikë një program të avancuar të trajnimit, të dizajnuar veçanërisht për

zyrtarët e Gjykatës Kushtetuese, përmes shtjellimit të temave si: “Ekipet e mira dhe kultura organizative”, “Komunikimi dhe konflikti”, “Ndërtimi i ekipeve dhe i besimit”, “Ndryshimi dhe komunikimi” dhe “Takimet e shkëlqyera”. Gjatë trajnimeve të mbajtura, znj. Webb ndau njohuritë e saj teorike dhe praktike, me qëllim të



ndërtimit të vlerave dhe primeve të organizimit të mirë dhe funksional brenda një institucioni, me theks të veçantë në metodat më të mira për ndërtimin e besimit të ndërsjellë, si dhe mekanizmat e komunikimit dhe të llogaridhënies brenda ekipeve.

Programi i trajnimit në përgjithësi pati si synim pajisjen e zyrtarëve të Gjykatës me njohuritë dhe aftësitë bazë për të zgjidhur sfidat që pashmangshëm paraqiten në një ambient të përbashkët pune. Secila prej punëtorive ishte konceptuar të jetë ndërvepruese dhe të nxisë pjesëmarrjen aktive të stafit, duke përdorur një varg teknikash të kombinuara si rastet studimore, ushtrimet në grupe të vogla, diskutimet në grup të gjerë dhe reflektimi individual.

Ky program i ngritjes së kapaciteteve të stafit të Gjykatës u mundësua përmes mbështetjes nga “Programi i Specialistëve të Fulbright”, financuar nga Departamenti Amerikan i Shtetit, Byroja për Edukim dhe Marrëdhënie Kulturore (ECA) dhe zbatuar nga Ambasada Amerikane në Prishtinë. Gjykata ka përfituar këtë mbështetje pas një procesi të hapur konkurrues dhe miratimit të projekt-propozimit të saj.



Aktgjykim

KO 27/21

Parashtrues

Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës

Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së nenit 94 (Mbikëqyrja) të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës

Rrethanat e rastit konkret ndërlidhen me kërkesën e ngritur në Gjykatën Kushtetuese nga ana e Gjykatës Supreme, për vlerësimin e kushtetutshmërisë së nenit 94 (Mbikëqyrja) të Ligjit të Punës, i cili, ndër të tjera, përcakton që mbikëqyrjen e zbatimit të dispozitave që rregullojnë marrëdhënien e punës e bën Inspektorati i Punës. Gjykata Supreme kishte një rast para saj që ndërlidhej me një konkurs pune për pozitën “Edukatore” në një shkollë në Komunën e Gjilanit, me ç’rast njëra nga kandidatet në këtë konkurs kishte paraqitur ankesë në Drejtorinë Komunale për Arsim në Gjilan, duke pretenduar parregullsi në këtë konkurs. Pas refuzimit të ankesës nga Drejtoria Komunale për Arsim, kandidatja kishte ushtruar, në mënyrë paralele, mjetet juridike dhe atë: (i) ankesë para Inspektoratit të Punës, me ç’rast kjo e fundit kishte urdhëruar anulimin e konkursit në fjalë; si dhe (ii) padi në Gjykatën Themelore në Gjilan, e cila kishte refuzuar padinë dhe kishte konfirmuar vendimet e organeve të Komunës së Gjilanit. Si pasojë, ankuesja kishte ushtruar revizion në Gjykatën Supreme. Kjo e fundit pezulloi procedurën vendimmarrëse lidhur me rastin para saj, duke referuar çështjen në Gjykatën Kushtetuese, për vlerësimin e përputhshmërisë së nenit 94 të Ligjit të Punës me dispozitat e caktuara Kushtetuese. Më saktësisht, Gjykata Supreme, para Gjykatës pretendoi se neni 94 i Ligjit të Punës nuk është në përputhshmëri me nenet 3 [Barazia para Ligjit], 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesioneve] dhe 54 [Mbrotjtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës, pasi i njëjti,

mes tjerash, cenon parimin e sigurisë juridike dhe të rendit juridik të Republikës së Kosovës, pasi mundëson procedura paralele lidhur me kontestet e punës para Inspektoratit të Punës dhe para gjykatave të rregullta lidhur me të njëjtën çështje, duke rezultuar kështu në vendime paralele dhe ndërhyrje të Inspektoratit të Punës në kompetenca gjyqësore, në kundërshtim me sigurinë juridike dhe rendin kushtetues të Republikës së Kosovës.

Bazuar në esencën e pretendimeve të ngritura, Gjykata vlerësoi fillimisht nëse në rrethanat e rastit konkret ndërhyrja e Inspektoratit të Punës në kompetenca të gjyqësorit ishte rezultat i papajtueshmërisë së normës së Ligjit të Punës me Kushtetutën apo rezultat i mënyrës së interpretimit dhe zbatimit të normës në fjalë nga Inspektorati i Punës, por edhe gjykatat e rregullta. Në këtë këndvështrim, Gjykata iu referua fillimisht përmbajtjes së nenit 94 të Ligjit të Punës i cili përcakton që mbikëqyrjen e zbatimit të dispozitave të Ligjit të Punës të cilat e rregullojnë marrëdhënien e punës, sigurinë dhe mbrojtjen në punë, e bën Inspektorati i Punës në bazë të Ligjit për Inspektoratin e Punës dhe Ligjit për Siguri në Punë. Në këtë kontekst, Gjykata saktësoi që bazuar në Ligjin e Punës dhe atë të Inspektoratit, është plotësisht i qartë fushëveprimi i kompetencës së Inspektoratit të Punës, i cili si trup inspektues dhe mekanizëm i pushtetit ekzekutiv, mbikëqyrë zbatimin e dispozitave të Ligjit të Punës të cilat e rregullojnë marrëdhënien e punës ndërmjet të punësuarit dhe punëdhënësit dhe mbikëqyrë zbatimin e Ligjit për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, në kuadër të fushëveprimit që përcakton Ligji për Inspektoratin: (i) zbatimin e masave ndëshkuese (gjobave) në rast të konstatimit të parregullsive nga ana e punëdhënësit; si dhe (ii) raportimin e këtyre parregullsive në ministrinë përkatëse ose te ndonjë autoritetet tjetër kompetent. Inspektorati i Punës nuk ka asnjë kompetencë që të zgjidh “kontestet e punës” apo ato që burojnë nga marrëdhënia e punës, mes të punësuarit dhe punëdhënësit, sepse bazuar në ligjet e aplikueshme, një kompetencë e tillë u takon qartësisht gjykatave të rregullta.

Në këtë aspekt, Gjykata ritheksoi se për dallim nga Inspektorati i Punës, Ligji i Punës e përcakton gjyqësorin si të vetmin autoritet përgjegjës në Republikën e Kosovës që i zgjidh “kontestet e punës” nga e drejta e punës, në mes të punësuarit dhe punëdhënësit. Gjykata po ashtu analizoi përmbajtjen e nenit 78 (Mbrotjtja e të drejtave për të punësuarit) të Ligjit të Punës, që përcakton procedurat ankimore brenda punëdhënësit dhe nenin 79 (Mbrotjtja e të punësuarit në Gjykatë) të Ligjit të Punës, që garanton të drejtën që çdo i punësuar i cili konsideron se

vendimi i punëdhënësit ka shkelur të drejtat e tij ose nuk merr përgjigje nga punëdhënësi, të inicioj kontest pune në Gjykatën kompetente. Gjykata theksoi se, funksionet gjyqësore mund t'i ushtrojnë vetëm gjykatat, sipas parimeve të përcaktuara me Kushtetutë dhe ligjet përkatëse. Për më tepër, është e qartë që Inspektorati i Punës sipas ligjit përcaktohet si trupë ekzekutive të cilën e themelon Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, dhe si i tillë, edhe në kuptim të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, gjegjësisht të nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të saj, nuk i plotëson kushtet as të një "tribunali të pavarur" nga ekzekutivi dhe as të një "gjykate" të themeluar me ligj. Organet inspektuese, varësisht sipas natyrës së funksioneve që ushtrojnë dhe statusit institucional të përcaktuar nga aktet që kanë themeluar ato, janë pjesë e pushtetit ekzekutiv dhe si të tilla nuk mund të ushtrojnë funksione të natyrës gjyqësore. Nëse do të veprohej kështu, kjo do të përbënte shkelje të parimit të ndarjes së pushteteve në cenim të rendit kushtetues të Republikës së Kosovës. Andaj, Gjykata konsideroi se në rastin konkret pretendimi për ndërhyrje në kompetenca të gjyqësorit nga ana e Inspektoratit të Punës, nuk është rezultat i papajtueshmërisë së përmbajtjes së nenit 94 të Ligjit të Punës me normat kushtetuese, por rezultat i mënyrës së interpretimit dhe zbatimit të nenit 94 të Ligjit të Punës dhe Ligjit për Inspektoratin e Punës, nga vet Inspektorati i Punës.

Për pasojë dhe bazuar edhe në sqarimet e dhëna në Aktgjykimin e publikuar, Gjykata konstatoi se neni 94 (Mbikëqyrja) i Ligjit të Punës është në përputhshmëri me nenet: 3 [Barazia para Ligjit], 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës, pasi dhe ndër të tjera, i njëjti nuk përcakton asnjë kompetencë që Inspektorati i Punës të zgjidhë "kontestet e punës" nga e drejta e punës mes të punësuarit dhe punëdhënësit, kompetencë kjo që bazuar në ligjet e aplikueshme, i takon pushtetit gjyqësor.



Aktgjykim

KO 173/21

Parashtrues

Komuna e Kamenicës

Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së neneve 3, 4, 5, 6, 7 dhe 9 të Udhëzimit Administrativ të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës (MASH) nr. 104/2020 për "Kriteret dhe Procedurat e Themelimit dhe Pushimit të Veprimtarisë së Institucioneve të Arsimit Parauniversitar"

Në vlerësimin e kushtetutshmërisë së Udhëzimit Administrativ të kontestuar, Gjykata, njëzëri vendosi që: (i) kërkesa është e pranueshme; dhe (ii) neni 3 (Themeluesi), paragrafët 5, 6 dhe 7 të nenit 6 (Verifikimi i kushteve), paragrafët 2 dhe 3 të nenit 7 (Vendimi) dhe paragrafët 6, 7 dhe 8 të nenit 9 (Pushimi i veprimtarisë së institucionit edukativ-arsimor ose paraleles së ndarë) të Udhëzimit Administrativ të kontestuar, nuk janë në përputhshmëri me paragrafin 2 të nenit 12 [Pushteti Lokal], paragrafin 1 dhe 3 të nenit 123 [Parimet e Përgjithshme] dhe me paragrafin 2 dhe 3 të nenit 124 [Organizimi dhe Funksionimi i Vetëqeverisjes Lokale] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe si të tilla, shfuqizohen.

Thelbi që ngërthejnë rrethanat e rastit konkret, ndërlidhet me kompetencat që i janë përcaktuar pushtetit qendror, përkatësisht Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës në njërën anë, dhe pushtetit lokal, përkatësisht komunave në anën tjetër, përkitazi me themelimin e institucioneve edukative-arsimore dhe paraleleve të ndara në komuna, përmes Udhëzimit të lartcekur Administrativ. I njëjti, ndër tjerash, saktëson se vendimi për themelimin dhe pushimin e institucioneve edukative-arsimore dhe paraleleve të ndara të nivelit parauniversitar, merret nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, bazuar në propozimin e komunës përkatëse. Vendimmarrja në nivel të pushtetit qendror,

përkatësisht Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, përkitazi me themelimin/pushimin e institucioneve edukative-arsimore dhe paraleleve të ndara në nivel parauniversitar, sipas parashtruesit të kërkesës, cenon përgjegjësitë komunale, në kundërshtim me dispozitat përkatëse kushtetuese dhe ato të ligjeve të aplikueshme, përkatësisht të Ligjit nr.04/L-032 për Arsimin Parauniversitar, Ligjit nr.03/L-68 për Arsimin në Komunitet të Republikës së Kosovës dhe Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, sipas të cilit, “ofrimi i arsimit publik parashkollor, fillor dhe të mesëm, duke përfshirë regjistrimin dhe licencimin e institucioneve edukative, punësimin, pagesën e rrogave dhe trajnimin e instruktorëve dhe administratorëve të arsimit”, përbën kompetencë vetanake të komunave dhe si e tillë, është kompetencë e “plotë dhe ekskluzive” në nivel komunal.

Fillimisht dhe sa i përket pranueshmërisë së kërkesës, Gjykata sqaron se, pas parashtrimit të kërkesës për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Udhëzimit Administrativ të kontestuar nga Kryetari i Komunës së Kamenicës, z. Qëndron Kastrati, më 17 tetor 2021, respektivisht 14 nëntor 2021, pas zhvillimit të raundit të dytë të zgjedhjeve lokale në Republikën e Kosovës, Kryetar i Komunës së Kamenicës u zgjodh, z. Kadri Rahimaj. Ky i fundit, përmes përfaqësuesit të tij, më 5 janar 2022, parashtoi në Gjykatë kërkesën për tërheqje të lëndës KO173/21, me arsyetimin se nuk ka interes juridik për shqyrtimin e saj. Gjykata, bazuar në praktikën e saj gjyqësore dhe rregullin 35 (Tërheqja, hedhja poshtë dhe refuzimi i kërkesës) të Rregullores së Punës, sipas të cilit, pavarësisht kërkesës për tërheqje, Gjykata mund të përcaktojë të vendosë përkitazi me kërkesën fillestare, fillimisht vlerësoi kërkesën e Kryetarit të ri të Komunës dhe vendosi të refuzojë të njëjtën, duke pasur parasysh interesin publik për vazhdimin e shqyrtimit dhe vendosjes meritore në rast, me theks në rëndësinë e qartësisht të pretendimeve për shkelje të parimeve kushtetuese lidhur me vetëqeverisjen lokale.

Ndërsa, sa i përket meritave të rastit, në adresimin e pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, Gjykata fillimisht shtjelloi parimet e përgjithshme lidhur me vetëqeverisjen lokale sipas Kushtetutës, Kartës Evropiane për Vetëqeverisjen Lokale, Opinioneve relevante të Komisionit të Venecias, ligjeve në fuqi në Republikën e Kosovës, si dhe praktikës gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese.

Gjykata, duke u bazuar në nenet 12, 123 dhe 124 të Kushtetutës, respektivisht, ndër të tjerash, ritheksoi se: (i) njësi themelore territoriale të vetëqeverisjes lokale në Republikën e Kosovës janë komunitet; (ii) organizimi dhe kompetencat e njësive të vetëqeverisjes lokale rregullohen me ligj; (iii) komunitet kanë

kompetenca “vetanake”, “të zgjeruara” dhe “të deleguara”; dhe (iv) rishikimi administrativ i akteve të komunave nga autoritetet qendrore në fushën

kompetencave të tyre, kufizohet në sigurimin e përputhjes me Kushtetutën dhe me ligjin. Për më tepër, bazuar në këto nene kushtetuese, Gjykata theksoi që, veprimtaria e organeve të vetëqeverisjes lokale bazohet në Kushtetutë dhe në ligje dhe respekton Kartën Evropiane për Vetëqeverisjen Lokale. Kjo e fundit, ndër të tjerash, dhe për aq sa është e rëndësishme për rrethanat e rastit konkret, përcakton që: (i) autoritetet lokale, brenda kufijve të ligjit, do të kenë diskrecionin e plotë për të ushtruar iniciativën e tyre në lidhje me çdo çështje që nuk përjashtohet nga kompetenca e tyre dhe nuk i është caktuar në kompetencë ndonjë autoriteti tjetër; (ii) kompetencat që u besohen autoriteteve lokale, normalisht duhet të jenë të plota dhe ekskluzive dhe ato nuk mund të minohen apo të kufizohen nga një autoritet tjetër, qendror apo rajonal, përveç siç përcaktohet me ligj; dhe (iii) çdo kontroll administrativ mbi autoritetet lokale mund të ushtrohet vetëm sipas formave dhe në rastet e parashikuara nga Kushtetuta ose me ligj.

Gjykata gjithashtu ritheksoi se, vetëqeverisja lokale është e një rëndësie të tillë në rendin kushtetues, sa që Kushtetuta (i) ka përcaktuar këto garanci, ndër të tjerash, në Dispozitat Themelore të saj; (ii) ka përcaktuar respektimin e Kartës Evropiane për Vetëqeverisjen Lokale; dhe (iii) me qëllim të sigurimit të mbrojtjes së këtyre garancive, në nenin 113 të saj, u ka dhënë komunave qasje të drejtpërdrejtë në Gjykatën Kushtetuese, në cilësi të palëve të autorizuar, që të kontestojnë kushtetutshmërinë e ligjeve ose të akteve të Qeverisë, të cilat cenojnë përgjegjësitë komunale ose zvogëlojnë të hyrat e komunës, në rast se komuna përkatëse është prekur nga ai ligj ose akt. Në përputhje me garancitë e lartcekura të Kushtetutës dhe Kartës Evropiane për Vetëqeverisjen Lokale, dhe referimin e të njëjtave në detyrimin që këto garanci të zbatohen edhe përmes ligjeve të aplikueshme, Gjykata gjithashtu rikujtoi që, bazuar në nenin 17 (Kompetencat vetanake) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, komunitet kanë kompetenca “të plota dhe ekskluzive” në ofrimin e arsimit publik parashkollor, fillor dhe të mesëm, duke përfshirë regjistrimin dhe licencimin e institucioneve edukative, punësimin, pagesën e rrogave dhe trajnimin e instruktorëve dhe administratorëve të arsimit. Në anën tjetër, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, bazuar në Ligjin për Arsimin Parauniversitar dhe Ligjin për Arsimin në Komunitet, ndër të tjerash, mban përgjegjësinë kryesore për planifikimin, caktimin e standardeve dhe sigurimin e cilësisë së sistemit të arsimit



parauniversitar, dhe ka përgjegjësinë të promovojë dhe të përmirësojë cilësinë dhe efikasitetin e arsimit dhe aftësisht përmes inspektimit të arsimit, monitorimit dhe vlerësimit me qëllim të ngritjes së cilësisë dhe mbikëqyrjes së zbatimit të legjislacionit në fuqi.

Duke zbatuar parimet e lartcekura në rrethanat e rastit konkret, përkatësisht vlerësimin kushtetues nëse Udhëzimi Administrativ i kontestuar cenon përgjegjësitë komunale, Gjykata, ndër tjerash, theksoi se kompetenca për vendimmarrje të plotë të pushtetit qendror për themelimin dhe shuarjen e institucioneve të nivelit parauniversitar në komuna, që i është dhënë Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës përmes neneve 3, 6, 7 dhe 9 të Udhëzimit Administrativ të kontestuar, sipas sqarimeve të dhëna në Aktgjykimin e publikuar, cenon “kompetencat vetanake” të komunës. Kjo sepse, bazuar në mënyrën e saktësuar në dispozitat përkatëse të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Ligjin për Arsimin në Komuna dhe Ligji për Arsimin Parauniversitar, vendimmarrja për themelimin e institucioneve të nivelit parauniversitar i takon komunave. Ndërsa, sa i përket neneve 4 (Kushtet për themelimin e institucionit edukativ-arsimor ose paraleles së ndarë) dhe 5 (Propozimi për themelimin e institucionit edukativ-arsimor ose paraleles së ndarë) të Udhëzimit Administrativ të kontestuar, të cilat, ndër tjerash, përcaktojnë kompetencën e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës për të përcaktuar kushtet që duhet të plotësojnë institucionet edukative-arsimore dhe paralelet e ndara, dhe dokumentacionit të nevojshëm përmes të cilit mund të vërtetohet plotësimi i të njëjtave, Gjykata vlerësoi se të njëjtat nuk cenojnë “kompetencat vetanake” komunale. Kjo sepse, në parim, kompetenca për përcaktimin e kriterëve dhe kushteve të përgjithshme që një institucion edukativ-arsimor ose paralele e ndarë duhet t'i plotësojë, përmes ligjeve të lartcekura të aplikueshme dhe siç është sqaruar në Aktgjykimin publikuar, i është përcaktuar Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.

Gjykata përfundimisht ritheksoi se, bazuar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, përkatësisht nenin 123 të saj, vetëqeverisja lokale është e garantuar dhe e rregulluar me ligj dhe bazuar në nenin 124 të saj, çdo rishikim administrativ i akteve të komunave nga autoritetet qendrore në fushën e kompetencave të tyre, kufizohet në sigurimin e përputhjes me Kushtetutë dhe ligj. Në kuptim të kësaj, Gjykata theksoi se pushteti qendror dhe në rrethanat e rastit konkret, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, përmes akteve nënligjore nuk mund t'i përcaktojë vetes kompetenca që nuk i janë përcaktuar me ligj të miratuar nga Kuvendi i Republikës, e të cilat kompetenca mund të ndërhyjnë në veprimtarinë e vetëqeverisjes lokale në

fushën e arsimit apo të cenojnë përgjegjësitë komunale në këtë fushë. Një parim i tillë, në kuptim të vetëqeverisjes lokale, buron edhe nga dispozitat e Kartës Evropiane për Vetëqeverisjen Lokale. Gjykata vëren se, Kushtetuta dhe ligjet e aplikueshme qartësisht saktësojnë ndarjen e kompetencave përkatëse, duke përfshirë edhe në fushën e arsimit dhe që të dy nivelet e qeverisjes, janë të detyruara të veprojnë në përputhje të plotë me të njëjtat.



GJEDNJ – Vendime të rëndësishme (1 korrik – 31 dhjetor 2021)

*** Autoritetet italiane nuk vepruan me shpejtësinë dhe zellin e duhur në trajtimin e akteve të dhunës në familje dhe nuk respektuan detyrimet e tyre ndaj Konventës (07/07/2022)**

Në aktgjykimin e Dhomës në rastin **Scavone kundër Italisë** (kërkesa nr. 32715/19) Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut vendosi, njëzëri, se **kishte pasur shkelje të aspektit përmbajtësor të nenit 3 (ndalimi i trajtimit çnjerëzor ose poshtërues)** të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në lidhje me periudhën nga 19 janari 2007 deri më 21 tetor 2008, dhe jo shkelje të aspektit përmbajtësor të nenit 3 të Konventës në lidhje me periudhën nga 21 tetori 2008 deri më 5 janar 2018; shkelje të aspektit procedural të nenit 3 të Konventës. Rasti kishte të bënte me dhunën në familje së cilës iu nënshtrua parashtruesja e kërkesës nga bashkëshorti i saj. Parashtruesja e kërkesës u ankua, në veçanti, se shteti i paditur kishte dështuar ta mbronte dhe ta ndihmonte atë. Ajo gjithashtu pretendoi se autoritetet nuk kishin vepruar me zellin dhe shpejtësinë e nevojshme, pasi ndjekja penale për disa vepra ishte parashkruar. Gjykata nuk mund të pranonte se qëllimi i mbrojtjes efektive kundër akteve të keqtrajtimit, përfshirë dhunën në familje, është arritur kur procedura penale është ndërprerë me arsyetimin se ndjekja ka qenë e parashkruar, ku kjo ka ndodhur si pasojë e dështimeve të autoriteteve. Veprat penale në lidhje me dhunën në familje duhet të klasifikohen ndër veprat më të rënda. Sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës, ishte e papajtueshme me detyrimet procedurale që dalin nga neni 3 që hetimet për këto vepra të ndërpriteshin përmes parashkrimit që rezultojnë nga mosveprimi i autoriteteve. Në rastin në fjalë, Gjykata vlerësoi se një situatë në të cilën autoritetet vendase, së pari – në bazë të mekanizmave që rregullojnë periudhat e parashkrimit në kornizën ligjore kombëtare – kishin mbështetur një sistem në të cilin parashkrimi ishte i lidhur ngushtë me veprimin gjyqësor edhe pasi kishte filluar procedura dhe, së dyti, e kishin ndjekur rastin me një shkallë të pasivitetit gjyqësor në papajtueshmëri me këtë kornizë, nuk mund të konsiderohet se plotëson kërkesat e nenit 3 të Konventës.

*** Mbledhja dhe mbajtja, nga shërbimi francez i dhurimit të gjakut (EFS), e të dhënave personale që pasqyrojnë orientimin e supozuar seksual të parashtruesit pa bazë faktike të provuar: shkelje e nenit 8 të Konventës (08/09/2022)**

Në aktgjykimin e Dhomës në rastin **Drelon kundër Francës** (kërkesa nr. 3153/16), Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut vendosi, njëzëri, se kishte pasur **shkelje të nenit 8 (e drejta për respektimin e**

jetës private dhe familjare) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Kërkesat kishin të bënin, së pari, me mbledhjen dhe ruajtjen, nga shërbimi francez i dhurimit të gjakut (EFS) të të dhënave personale që pasqyrojnë orientimin e supozuar seksual të parashtruesit të kërkesës – së bashku me refuzimin e ankesës së tij penale për diskriminim – dhe, së dyti, refuzimi i ofertave të tij për të dhuruar gjak, së bashku me përjashtimin nga ana e Conseil d'État të kërkesës së tij për rishikim gjyqësor, duke kontestuar një urdhrë të datës 5 prill 2016, i cili ndryshoi kriteret e përzgjedhjes për dhuruesit e gjakut. Duke adresuar kërkesën e parë, Gjykata konstatoi se mbledhja dhe mbajtja e të dhënave të ndjeshme personale përbën një ndërhyrje në të drejtën e parashtruesit të kërkesës për respektimin e jetës së tij private.

Kjo ndërhyrje kishte një bazë ligjore të parashikueshme si kompetencë diskrecionale e autoriteteve për të ngritur bazën e të dhënave shëndetësore për këtë qëllim ishte e rregulluar mjaftueshëm nga ligji i atëhershëm i aplikueshëm i 6 janarit 1978. Përderisa mbledhja dhe ruajtja e të dhënave personale në lidhje me kandidatët për dhurues gjaku kontribuoi në garantimin e sigurisë së gjakut, megjithatë ishte veçanërisht e rëndësishme që të dhënat e ndjeshme të përfshira të ishin të sakta, të përditësuara, përkatëse dhe jo të tepërta në lidhje me qëllimet e ndjekura; dhe periudha e ruajtjes së të dhënave duhej të kufizohej në atë që ishte e nevojshme.

Gjykata vlerësoi, së pari, se edhe pse parashtruesi i kërkesës kishte refuzuar t'u përgjigjej pyetjeve në lidhje me jetën e tij seksuale gjatë ekzaminimit mjekësor para dhurimit të gjakut, të dhënat përfshinin kundërlindikacion për dhënien e gjakut që ishte specifik për burrat që kishin marrëdhënie seksuale me burra të tjerë. Ajo arriti në përfundimin se të dhënat në fjalë bazoheshin në spekulime të thjeshta pa ndonjë bazë faktike të provuar. Së dyti, pasi vuri në dukje se qeveria nuk kishte treguar se periudha e ruajtjes së të dhënave (deri në vitin 2278 në atë kohë) ishte rregulluar në mënyrë të tillë që nuk mund të kalonte periudhën e nevojshme për qëllimin e ndjekur, Gjykata konstatoi se periudha e tepruar e ruajtjes kishte bërë të mundur që të dhënat të përdoren në mënyrë të përsëritur kundër parashtruesit të kërkesës, duke sjellë përjashtimin automatik të tij nga të qenit dhurues gjaku.

Pra, kishte pasur shkelje të nenit 8 të Konventës për shkak të mbledhjes dhe ruajtjes së të dhënave personale në fjalë. Për sa i përket kërkesës së dytë, Gjykata hodhi poshtë si të paafatshme ankesat lidhur me vendimet që përjashtojnë parashtruesin e kërkesës nga dhurimi i gjakut më 16 nëntor 2004 dhe 9 gusht 2006.

Përkritazi me vendimin e 26 majit 2016, Gjykata konstatoi se parashtruesi i kërkesës nuk mund të thirrej në shkelje të neneve 8 dhe 14 të Konventës në lidhje me urdhrin e datës 5 prill 2016 pasi ai nuk ishte ende në fuqi në datën e refuzimit në fjalë.



*** Gjykata Evropiane thotë se procedurat që rezultojnë me shkarkimin e prokurorit shqiptar duhet të rihapen (04/10/2022)**

Në aktgjykimin e Dhomës në rastin **Besnik Cani kundër Shqipërisë** (kërkesa nr. 37474/20), Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut vendosi, njëzëri, se: **kishte pasur shkelje të nenit 6 paragrafi 1 (e drejta për një proces të rregullt)** të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Rasti kishte të bënte me një ish-prokuror i cili u shkarkua në vitin 2020 si pjesë e një procesi të jashtëzakonshëm për rivlerësimin e të gjithë gjyqtarëve dhe prokurorëve në detyrë – të njohur si procedura e vetingut – pas një reforme në sistemin e drejtësisë në Shqipëri, dhe dyshimet e tij për një gjyqtar të caktuar për të dëgjuar rastin e tij. Parashtruesi i kërkesës argumentoi se gjyqtari në fjalë duhej të ishte përjashtuar sepse ai ishte shkarkuar më parë si gjyqtar i gjykatës së rrethit, që do të thotë se ai ishte caktuar në Dhomën e Posaçme të Apelit, e cila kishte shqyrtuar rastin e tij në kundërshtim me rregullat për përshtatshmëri.

Përveç kësaj, gjykatat vendase kishin refuzuar të shqyrtonin argumentet e parashtruesit të kërkesës në lidhje me këtë. Gjykata konstatoi se argumenti i parashtruesit të kërkesës kishte çuar në një pretendim serioz dhe të argumentuar për shkelje të qartë të një rregulli themelor të ligjit të brendshëm që kishte ndikuar negativisht në caktimin e njërës prej gjyqtarëve të ulur në seancën gjyqësore që kishin dëgjuar rastin e tij. Për rrjedhojë, ajo arriti në përfundimin se e ishte shkelur drejta e parashtruesit të kërkesës për një “gjykatë të krijuar me ligj”. Ajo gjithashtu konstatoi sipas nenit 46 (forca detyruese dhe ekzekutimi i vendimeve) se korrigjimi më i përshtatshëm për shkeljen e të drejtave të parashtruesit të kërkesës do të ishte rihapja e rastit dhe rishqyrtimi i tij në pajtim me kërkesat e nenit 6 paragrafi 1 të Konventës. Megjithatë, konstatimi i një shkeljeje në vetvete nuk mund të konsiderohet se kërkon rihapjen e të gjitha rasteve të ngjashme që ndërkohë janë bërë res judicata sipas ligjit të brendshëm.

*** Gjykata konstaton mangësi procedurale në shqyrtimin e mëvonshëm të vdekjes nga eutanazia të nënës së parashtruesit të kërkesës (04/10/2022)**

Në aktgjykimin e Dhomës në rastin **Mortier kundër Belgjikës** (kërkesa nr. 78017/17), Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut nxori tri konstatime pa shkelje dhe një konstatim për shkelje të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Rasti kishte të bënte me vdekjen nga eutanazia e nënës së parashtruesit të kërkesës, pa u informuar parashtruesi i kërkesës ose motra e tij. Nëna e parashtruesit të kërkesës nuk kishte dashur të njoftonte fëmijët e saj lidhur me kërkesën e saj për eutanazi, pavarësisht këshillave të përsëritura nga mjekët. Gjykata shpjegoi se rasti nuk kishte të bënte me atë nëse kishte të drejtë për eutanazi, por për pajtueshmërinë me Konventën e

aktit të eutanazisë të kryer në rastin e nënës së parashtruesit të kërkesës. Gjykata më pas konstatoi si në vijim:

- Me një shumicë (pesë vota kundër dy), se **nuk kishte pasur shkelje të nenit 2 (e drejta për jetën) të Konventës për shkak të kornizës legislative që rregullon aktet dhe procedurën para-eutanazisë**. Gjykata konstatoi se dispozitat statutoire për eutanazinë përbënin në parim një kornizë legislative që siguronte në mënyrë specifike mbrojtjen e të drejtës për jetën e pacientëve siç kërkohet me nenin 2 të Konventës.

- Me shumicë (pesë vota kundër dy), se **nuk kishte pasur shkelje të nenit 2 (e drejta për jetën) për shkak të kushteve në të cilat ishte kryer akti i eutanazisë në rastin e nënës së parashtruesit të kërkesës**. Gjykata vlerësoi se nga provat para saj nuk mund të thuhej se veprimi në fjalë, i kryer në pajtim me kornizën e vendosur ligjore, kishte shkelur kërkesat e nenit 2 të Konventës.

- Njëzëri, se **ka pasur shkelje të nenit 2 (e drejta për jetën) për shkak të procedurës së shqyrtimit pas eutanazisë në rastin konkret**. Gjykata konstatoi se shteti kishte dështuar në përmbushjen e detyrimit pozitiv procedural, për shkak të mungesës së pavarësisë së Bordit Federal për Rishikimin dhe Vlerësimin e Eutanazisë dhe kohëzgjatjen e hetimit penal në këtë rast.

- Me shumicë (gjashtë vota kundër një), se **nuk ka pasur shkelje të nenit 8 (e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare)**. Gjykata konstatoi se mjekët që ndihmonin nënën e parashtruesit të kërkesës kishin bërë gjithçka të arsyeshme, në pajtim me ligjin, detyrën e tyre të konfidencialitetit dhe sekretit mjekësor, së bashku me udhëzimet etike, për të siguruar që ajo të kontaktonte fëmijët e saj në lidhje me kërkesën e saj për eutanazi.

*** Legjislacioni që parasheh ndërprerjen e pensionit të burrit të ve kur fëmija më i vogël mbush moshën madhore është diskriminues (11/10/2022)**

Në aktgjykimin e Dhomës në rastin **Beeler kundër Zvicrës** (kërkesa nr. 78630/12) Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut konstatoi, me shumicë (12 vota kundër 5), se: **kishte pasur shkelje të nenit 14 (ndalimi i diskriminimit) në lidhje me nenin 8 (e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare)** të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Rasti kishte të bënte me ndërprerjen e pensionit të parashtruesit të kërkesës burrit të ve pasi fëmija i tij më i vogël kishte mbushur moshën madhore. Ligji Federal për sigurimin e pleqërisë dhe të mbijetuarve parashikonte që e drejta për pension të burrave të ve përfundonte kur fëmija më i vogël mbushte moshën 18 vjeç, ndërsa kjo nuk vlente për një grua të ve. Para Gjykatës, parashtruesi i kërkesës argumentoi se ai ishte diskriminuar në lidhje me të gratë e veja në një situatë të ngjashme, të cilat nuk do të kishin humbur të drejtën për pension. Qeveria pretendoi se ishte ende e justifikueshme të mbështetej në supozimin se burri



siguronte mirëmbajtjen financiare të gruas, veçanërisht kur ajo kishte fëmijë, dhe kështu t'u ofronte një nivel më të lartë mbrojtjeje të vejave sesa të burrave të ve. Sipas këndvështrimit të tyre, trajtimi i dallimeve bazohej jo në stereotipizimin gjinor, por në realitetin shoqëror.

Së pari, Gjykata vuri në dukje se midis viteve 1997 dhe 2010, parashtruesi i kërkesës kishte marrë pensionin e burrit të ve dhe kishte organizuar aspektet kryesore të jetës së tij familjare. të paktën pjesërisht, në bazë të ekzistimit të pensionit. Situata delikate financiare në të cilën ai ishte gjendur në moshën 57-vjeçare, për shkak të humbjes së pensionit dhe vështirësive për t'u rikthyer në një treg pune nga i cili kishte munguar prej 16 vitesh, ishte pasojë e vendimit që kishte marrë prej vitesh. më herët për interesa të familjes së tij, i mbështetur nga viti 1997 e në vazhdim me marrjen e pensionit të burrit të ve. Prandaj, Gjykata vendosi se nenet 8 dhe 14 të Konventës ishin të aplikueshëm në rastin në fjalë.

Më pas, Gjykata konstatoi se megjithëse parashtruesi i kërkesës kishte qenë në një situatë analoge për sa i përket nevojave të tij për jetesë, ai nuk ishte trajtuar në të njëjtën mënyrë si gratë e veja. Prandaj ai i ishte nënshtruar një trajtimi të pabarabartë. Qeveria nuk kishte treguar se kishte arsye shumë të forta ose “arsye veçanërisht të rëndësishme dhe bindëse” që justifikonin ndryshimin në trajtim për shkak të gjinisë. Sipas mendimit të Gjykatës, Qeveria nuk mund të mbështetej në supozimin se burri e mbështeti gruan financiarisht (koncepti i “ushqyesit të familjes”) në mënyrë që të justifikonte dallimin në trajtim që i vendos burrat në pozitë më të pafavorshme në raport me gratë e veja. Ajo konstatoi se legjislacioni në fjalë kontribuoi më tepër në përjetësimin e paragjytimeve dhe stereotipeve në lidhje me natyrën ose rolin e gruas në shoqëri dhe ishte i pafavorshëm si për karrierën e grave ashtu edhe për jetën familjare të burrave.

*** Dallimi në trajtim midis personave të lindur në Francë para dhe pas pavarësisë së Algjerisë për prindërit e lindur në Algjerinë Franceze: jo diskriminues sipas nenit 14 të Konventës (13/10/2022)**

Në aktgjykimin e Dhomës në rastin **Zeggai kundër Francës** (kërkesa nr. 12456/19), Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut konstatoi, njëzëri, se: **nuk kishte pasur shkelje të nenit 14 (ndalimi i diskriminimit) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut**, marrë së bashku me nenin 8 (e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare). Rasti kishte të bënte me refuzimin e kërkesës së parashtruesit për një vërtetim të shtetësisë franceze. Ai ishte lindur në Francë, para pavarësisë së Algjerisë, nga prindër që në atë kohë ishin ende shtetas francezë. Ai ka jetuar vazhdimisht në Francë dhe vëllezërit dhe motrat e tij, të lindur pas pavarësisë së Algjerisë, kanë marrë shtetësinë franceze. Ai kishte pasur më parë një kartë identiteti franceze dhe kartë të votuesit, të lëshuara gabimisht nga autoritetet franceze. Ai u ankua në Gjykatë se i ishte nënshtruar

diskriminimit të ndaluar me nenin 14. Gjykata vërejti se, prindërit e parashtruesit të kërkesës, të cilët kishin lindur në Algjerinë franceze dhe ishin nën statusin civil vendas, nuk kishin shfrytëzuar mundësinë për t'u njohur si shtetas francezë duke nënshkruar një deklaratë njohjeje. Ajo nuk pa asnjë arsye për të vënë në dyshim legjitimitetin e dallimit të bërë midis fëmijëve të mitur të individëve që ishin nën statusin civil lokal algjerian në varësi të datës së lindjes së tyre, pra para ose pasi Algjeria fitoi pavarësinë. Ajo konstatoi se ky dallim, në atë kohë, kishte qenë i përshtatshëm për qëllimin legjitim të ndjekur, përkatësisht për të siguruar që fëmijët e mitur të kishin automatikisht të njëjtin status si prindërit e tyre në lidhje me kombësinë franceze, duke pasur parasysh se kishte lindur pyetja nëse prindërit e tyre mbetën shtetas francezë, pikërisht për shkak dhe në kontekstin e pavarësisë së Algjerisë. Gjykata vlerësoi më tej se ndryshimi në trajtim midis parashtruesit të kërkesës dhe vëllezërve e motrave të tij nuk lidhej me parimin e qasjes në shtetësinë franceze, por me rrugët në dispozicion për një qasje të tillë. Ndërsa theksoi se shteti i paditur kishte bërë një gabim në lëshimin e kartës së identitetit dhe kartës së votimit për një individ që nuk kishte më shtetësi franceze, ajo zbuloi se kjo çështje nuk kishte asnjë ndikim në pyetjen përpara Gjykatës nëse ndryshimi në trajtim për të cilin ankohej parashtruesi i kërkesës kishte qenë diskriminues. Duke pasur parasysh hapësirën e gjerë të vlerësimit që i ishte dhënë shtetit të paditur, Gjykata pranoi se masat e miratuara kishin qenë në proporcion me qëllimin legjitim të ndjekur. Ajo konkludoi se ndryshimi në trajtim për të cilin ankohej parashtruesi i kërkesës, në gëzimin e të drejtës së tij për respektimin e jetës së tij private, ishte bazuar në një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm.

*** E drejta e fëmijës për jetën private shkelet nga mungesa e dispozitës në ligjin zviceran, deri në vitin 2018, për mënyrat alternative të njohjes së fëmijëve të lindur nga çiftet të së njëjtës gjini përmes surrogacisë (22/11/2022)**

Në aktgjykimin e Dhomës në rastin **D.B. dhe të tjerët kundër Zvicrës** (kërkesat nr. 58817/15 dhe 58252/15) Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut konstatoi, me shumicë prej gjashtë votash kundër një, se kishte pasur shkelje të nenit 8 (e drejta për respektimin e jetës familjare të një fëmije të lindur nga surrogacia) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dhe- njëzëri, se nuk kishte pasur shkelje të nenit 8 (e drejta për respektimin e jetës familjare të babait të synuar dhe babait gjenetik). Rasti kishte të bënte me një çift të së njëjtës gjini, të cilët ishin partnerë të regjistruar dhe kishin lidhur kontratë për surrogaci gestacionale në Shtetet e Bashkuara, sipas së cilës kishte lindur parashtruesi i tretë. Parashtruesit e kërkesës u ankuan në veçanti se autoritetet zvicerane kishin refuzuar të njihnin marrëdhënien prind-fëmijë të themeluar nga një gjykatë amerikane ndërmjet babait të synuar (parashtruesi i parë) dhe fëmijës së lindur me surrogaci (parashtruesi i tretë). Autoritetet



zvicrane kishin njohur marrëdhënien prind-fëmijë midis babait gjenetik (parashtruesi i dytë) dhe fëmijës. Gjykata deklaroi se, tipari kryesor që e dallonte rastin nga ato që kishte vendosur më parë ishte se dy parashtruesit e parë ishin çift i të njëjtës gjini në një partneritet të regjistruar. Lidhur me parashtruesin e tretë, Gjykata vlerësoi se, në kohën kur ai kishte lindur, ligji i brendshëm nuk u kishte dhënë parashtruesve të kërkesës asnjë mundësi për njohjen e marrëdhënies prind-fëmijë midis prindit të synuar (parashtruesi i parë) dhe fëmijës. Birësimi ishte i hapur vetëm për çiftet e martuara, me përjashtim të atyre në partneritete të regjistruara. Vetëm deri më 1 janar 2018 ishte bërë e mundur të birësohej fëmija i një partneri të regjistruar. Kështu, për gati shtatë vjet e tetë muaj, parashtruesit e kërkesës nuk kishin pasur mundësi të siguronin njohjen përfundimtare të marrëdhënies prind-fëmijë.

Prandaj, Gjykata vendosi që autoritetet zvicerane të ndalojnë njohjen e certifikatës së huaj të lindjes të lëshuar në mënyrë të ligjshme për sa i përket marrëdhënies prind-fëmijë midis babait të synuar (parashtruesi i parë) dhe fëmijës së lindur nga një surrogaci në Shtetet e Bashkuara, pa parashikuar mjetet alternative të njohjes së asaj marrëdhënieje, nuk kishin qenë në interesin më të mirë të fëmijës. Me fjalë të tjera, pamundësia e përgjithshme dhe absolute, për një periudhë të konsiderueshme kohore, për të fituar njohjen e marrëdhënies ndërmjet fëmijës dhe parashtruesit të parë, kishte çuar në një ndërhyrje joproporcionale në të drejtën e parashtruesit të tretë për respektimin e jetës private sipas nenit 8. Prandaj, Zvicra kishte tejkaluar lirinë e saj të vlerësimit duke mos bërë parashikime legjislative në kohë për një mundësi të tillë. Lidhur me parashtruesit e parë dhe të dytë, Gjykata së pari vlerësoi se marrëveshja e surrogacisë që ata kishin përdorur për të krijuar familje ishte në kundërshtim me politikën publike zvicerane. Ajo vazhdoi të vlerësonte se vështirësitë praktike që mund të hasnin në jetën e tyre familjare në mungesë të njohjes sipas ligjit zviceran të marrëdhënieve ndërmjet parashtruesve të parë dhe të tretë ishin brenda kufijve të përputhshmërisë me nenin 8 të Konventës.

* Aktgjykimet për shkarkimin e dy prokurorëve shqiptarë: pa problem sistematik (13/12/2022)

Aktgjykimet e Dhomës në rastet **Nikëhasani kundër Shqipërisë** (kërkesa nr. 58817/15) dhe **Sevdari kundër Shqipërisë** (kërkesa nr. 58252/15) kishin të bënin me dy prokurorë që ishin shkarkuar nga detyra pasi Shqipëria kishte nisur një reformë të gjerë në sistemin e drejtësisë në vitin 2016.

Reforma përfshinte një rivlerësim të jashtëzakonshëm të të gjithë gjyqtarëve dhe prokurorëve në detyrë – të njohur ndryshe si “procedurat e vetingut”. Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut konstatoi, me gjashtë vota kundër një, se: **nuk kishte pasur shkelje të nenit 8 (e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare)** të Konventës Evropiane për të

Drejtat e Njeriut përkitazi me znj. Nikëhasani. Ajo vlerësoi se shkarkimi i saj ishte i justifikuar, procesi i vetingut kishte nxjerrë në pah dyshime serioze mbi përshtatshmërinë e saj financiare pas një shqyrtimi të kujdesshëm të rastit së saj.

Nga ana tjetër, ajo konstatoi, njëzëri, se: **kishte pasur shkelje të nenit 8 të Konventës Evropiane që kishte të bënte me shkarkimin e znj. Sevdari.** Gjatë procesit të vetingut nuk kishte asnjë shenjë të keqbesimit në deklaratat e saj; çdo parregullsi e supozuar kishte të bënte në thelb me pagesën e tatimit mbi disa nga të ardhurat e bashkëshortit të saj nga aktivitetet e ligjshme jashtë vendit.

Gjykata konsideroi në bazë të nenit 46 (forca detyruese dhe ekzekutimi i vendimeve) se një korrigjim i duhur për znj. Sevdari do të ishte rihapja e procedurës. Kjo nuk do të thotë, megjithatë, se funksionimi i procesit aktual të vetingut në Shqipëri në përgjithësi zbuloi ndonjë problem sistematik. Në të dy vendimet, Gjykata iu referua vendimit të saj kryesor të vitit 2021, Xhoxhaj kundër Shqipërisë, në të cilin kishte vendosur se procesi i vetingut ishte në tërësi i drejtë dhe i paanshëm dhe i ishte përgjigjur një nevojë urgjente për të luftuar korrupsionin në vend dhe për të rikthyer besimin e publikut në sistemin e drejtësisë.

(Për më shumë hollësi vizitoni faqen e internetit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut: www.echr.coe.int)

INFORMATA PËR GJYKATËN

Ndërtesa e Gjykatës Kushtetuese:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, që nga funksionalizimi i saj më 2009, është e vendosur në ish-objektin e Trupave Mbrojtëse të Kosovës, që ndodhet në qendër të Prishtinës, në lagjen “Pejton”. Ky lokacion i Gjykatës, në qendër të kryeqytetit, është simbol i qasjes së barabartë të të gjithë qytetarëve dhe të palëve të tjera të autorizuar në drejtësinë kushtetuese. Ky objekt ndër vite është përshtatur për nevojat dhe për natyrën e punës së Gjykatës Kushtetuese. Kjo është bërë me ndihmën e donatorëve, siç është rasti me ndërtimin e sallës së gjykimeve, që është financuar nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Turqisë në vitin 2010, themelimin e Bibliotekës së Gjykatës, e cila u mbështet në tërësi nga projekti i GIZ-it për Reformë Ligjore, si dhe sigurimi i zyrave shtesë (kontejnerë), donacion nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Turqisë në vitin 2011.

Objekti i Gjykatës ka gjithsej 1 937 m² hapësirë të shfrytëzueshme për punë, që shfrytëzohet nga 65 punonjës.



ADRESA

Rruga: “Perandori Justinian”, nr. 44, 10 000 - Prishtinë

Tel: +383 (0)38 60 61 62

Mob: +383 (0)45 200 595; +383 (0)45 200 576

Fax: +383 (0)38 60 61 70

E-mail: gjykata.kushtetuese@gjk-ks.org

Ueb: www.gjk-ks.org